



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 30.12.2020 morri

VENDIM

Procedura për lëndën 12-3807 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-3807/1 me datë 26.08.2019 dorëzuar nga parashtrues, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutejshëm për lëndën 12-3807 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-3807 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-3807 nga viti 2019 e formuar pas kërkesës me nr. 12-3807/1 me datë 26.08.2019, dorëzuar deri e Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga

Denoncimi i dorëzuar në fakt paraqet kërkesë të cilën parashtruesi e ka dorëzuar deri tek Këshilli për sigurim, ndjekje dhe vlerësim të kualitetit të punës së mediacionit, me të cilën kërkon që t'i dorëzohen të dhëna dhe dokumente (procesverbale dhe vendime) në përputhje me Kushtetutën e RM dhe Rregulloren për mënyrën e kryerjes së punës të Këshillit, dhe të cilën Kërkesë në formë të kopjes e ka dorëzuar edhe deri tek KSHPK dhe institucionet tjera. Parashtruesi i denoncimit ka qenë anëtar i Këshillit dhe të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin e ka kërkuar në përputhje me të drejtat e veta që burojnë nga Kushtetuta, Ligji për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik dhe Ligji për procedurë të parashtrësive dhe propozimeve.

Në fundin e Kërkesës së dorëzuar, parashtruesi thekson se nëse nuk do të veprohet për kërkesën e tij të dorëzuar për qasje të lirë, ai do të dorëzon kallëzim penal kundër Këshillit për vepër penale të kryer parandalim të qasjes kah sistemi informatik publik, si dhe procedura tjera për kundrëvajtje. Gjithashtu, parashtruesi thekson se si bazë për kallëzim penal do të jenë edhe dyshimet e tij se nga ana e Kryetari të Këshillit i cili vetëvetiu ka marrë vendime, edhe pse në përputhje me Aktet e Këshillit në emër të Këshillit ai nuk mundet vetë të merr vendime ose akte tjera – vërtetime, licenca, leje dhe të ngjajshme, si dhe për dyshime se disa nga vërtetimet dhe licencat janë dhënë në procedurë adekuate në përputhje me Ligjin për mediacion dhe Rregulloren për punë të Këshillit, e cila sipas tij paraqet vepër penale punë të pa matura në shërbim dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare me të cilën mund të parashtrohet kallëzim penal deri tek prokurori kompetent.

Gjatë rishikimi të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe me qëllim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzon të dhëna shtesë dhe informacione në lidhje me rastin e lëndës dhe të jep sqarim në lidhje me akuzat e lëndës. Pas kërkesës së KSHPK nuk është dorëzuar lajmërim nga ana e parashtruesit.

Duke pasë parasyshtë të shënuarën mësipër dhe gjendjen faktike të rastit të lëndës, KSHPK konstaton se për kërkesën e tij nuk është vepruar dhe nuk janë fituar të dhëna shtesë dhe informacione të cilat janë kërkuar nga parashtruesi i denoncimit, me çka vlerëson se Komisioni shtetëror nuk ka elemente për veprim të mëtutëshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshtë të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si me dispozitat e këtij vendimi.

Është vendosur me datë 30 dhjetor 2020, me numër 12-2247/2

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi
Pas përfundimit të KSHPK;
Punoi: J. C., Këshilltarë
Miratoi: m-r V. G., anëtarë i KSHPK

KOMISIONI SHТETӨRӨRӨ ПӨР
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Zëvendës-kryetarë: Sofka Pejovska Dojçinovska